


LËVIZJA E PAGAVE TË DISA INSTITUCIONEVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Shfrytëzues buxhetor
dhe trupa rregullator

INFORMATOR KUANTITATIV



WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

Projekt:

“Mbështetje për reformën parlamentare të Maqedonisë”

Zbatuesi:

Fondacioni Westminster për Demokraci (Maqedoni)

Autor:

Petar Trajkov

Sanja Trifunovska

Nadire Latifi

Prill, 2018



Ky produkt është përgatitur në suaza të projektit “Mbështetje për reformën parlamentare të Maqedonisë”, financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me përkrahje të Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë gjithmonë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.



WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

LËVIZJA E PAGAVE TË DISA INSTITUCIONEVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Shfrytëzues buxhetor
dhe trupa rregullator

INFORMATOR KUANTITATIV

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
I. Pagat e nëpunësve administrativ	7
I. 1. Lëvizja e pagave të nëpunësve administrativ shtetëror	7
I. 2. Neto dhe bruto pagat mesatare në administratën publike në raport me neto dhe bruto pagat mesatare në Republikën e Maqedonisë nga viti 2010 deri më sot.....	10
I.3. Bruto dhe neto paga për pjesën e shfrytëzuesve buxhetor të Buxhetit qendror nga viti 2016 deri në vitin 2018	15
I.4. Shpenzime për paga dhe kompensime dhe për punësime të përkohshme nga shpenzimet e përgjithshme në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për periudhën 2010 deri në vitin 2018	20
I.5. Bruto dhe neto pagat në trupat rregullator të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016	23
Lista e burimeve	26

HYRJE

Lëndë e kësaj pasqyre kuantitative është paraqitja e lëvizjes së pagave në administratën publike, pastaj shpenzimet buxhetore për paga dhe kompensime dhe për punësime të përkohshme për periudhën prej vitit 2010 deri më sot, si dhe shpenzimet për paga dhe kompensime për të punësuar, për shfrytëzues buxhetor të caktuar, të Buxhetit Qendror.¹ Gjithashtu, në këtë pasqyrë është bërë prezantimi i bruto pagave mujore për të punësuar në trupa rregullatorë.

Të dhënat e përdorura në informatorin kuantitativ janë marrë nga raporte zyrtare, njoftime dhe buletin të Entit Shtetëror për Statistikë të Republikës së Maqedonisë dhe të Ministrisë së Financave të Maqedonisë, si dhe raportet financiare dhe raportet vjetore të trupave rregullator të Republikës së Maqedonisë. Informatori kuantitativ përmban edhe përlllogaritje të vetë autorit.

Edhe pse nuk ekziston përkufizim më i saktë për administratën publike, ekziston pajtueshmëri e gjerë në mesin e komunitetit, me këtë term të nënkuptohen të gjitha institucionet publike që janë të kyçura drejtpërdrejtë në zbatimin e ligjeve të një shteti. Në vendet e zhvilluara demokratike, këto institucione shërbejnë si shërbim i qytetarëve në realizimin e të gjitha të drejtave që ju garantohen me ligj. Sipas L. D. Vajt, “Administratën publike e përbëjnë të gjitha operacionet që kanë për qëllimet realizimin dhe zbatimin e politikave publike”. Nga shteti në shtet, vërehen dallime në statusin juridik të kësaj kategorie të të punësuarve, por zakonisht quhen nëpunës publik, nëpunës shtetëror, nëpunës administrativ dhe ngjashëm. Në Republikën e Maqedonisë nga viti 2014 të punësuarit në administratën publike quhen nëpunës administrativ. Nëpunësit administrativ janë të punësuarit në administratën publike dhe shtetërore, të cilët kryejnë punë administrative: profesionale – administrative, normative - juridike, përmbartuese, statistikore, administrative - mbikëqyrëse, planifikuese, informatike, kadrovike, materiale, financiare, kontabiliste, informative dhe punë të tjera të karakterit administrativ. Me fjalë të tjera, këta punëtorë i zgjidhin rastet sipas kërkesave të qytetarëve dhe personave juridikë kur ushtrojnë të drejtat e tyre ose i përmbushin detyrimet e tyre ligjore ndaj shtetit, kryejnë mbikëqyrje (inspektim, profesional etj.), kryejnë analiza të ekspertëve, përgatisin rregulloret për nevojat e autoriteteve shtetërore etj.²

Pagat e punëtorëve në sektorin publik rregullohen në mënyrë të fragmentuar – me ligje të veçanta dhe marrëveshje kolektive. Ligji për nëpunësit administrativ përmban rregulla për pagat, shtesat dhe kompensimet e pagave vetëm për grupin e nëpunësve administrativ. Për grupet të tjera të punëtorëve në sektorin publik, të cilin e përbëjnë numri më i madh i të punësuarve në sektorin publik, e drejta për pagë është përcaktuar në ligj të veçantë (për shembull, Ligji për punë të brendshme, Ligji për shërbim në armatë etj.) ndërkaq, nga ana tjetër, komponentët e pagës, shtesat dhe kompensimet, si dhe mënyra e përlllogaritjes dhe lartësia e tyre janë të rregulluara me marrëveshje kolektive, rregullore, vendime etj. Nga aspekti i të gjithë sektorit publik, është evidente ekzistimi i sistemit jo konsistent të pagave. Ka disproporcion në lartësinë e pagave të punëtorëve, madje edhe kur kryejnë punë të njëjta dhe detyra të njëjta të punës. Pagat në institucione të ndryshme, siç janë trupat rregullator, fondet dhe 29 ndërmarrje publike, janë dukshëm më të larta sesa pagat e të punësuarve të shfrytëzuesit buxhetor. Sistemi i pagave i vendosur në këtë mënyrë krijon vështirësi gjatë menaxhimit, në veçanti në rastet e rritjes ose

¹ LIGJI PËR BUXHETET, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 64/05 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 64/05, 04/08, 103/08, 4/08, 103/08, 156/09, 95/10 156/09, 95/10, 180/11 и 171/12 и 171/12 dhe 171/12); Buxheti qendror dhe plani vjetor i të ardhurave, të ardhura të tjera dhe mjete të refuzuara, ndërsa është në lidhje me shfrytëzuesit buxhetor të pushtetit qendror dhe i përfshin buxhetet themelore, buxhete nga donacione, buxhetin e huazimeve dhe buxhetin e aktiviteteve vetë financuese.

² SA DHE ÇFARË SEKTORI PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)? Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN) janar 2017 [https://cup.org.mk/publications/Monitoring%20izvestaj_Mac_f%20\(2\).pdf](https://cup.org.mk/publications/Monitoring%20izvestaj_Mac_f%20(2).pdf)

zvogëlimit të lartësisë së pagave, që rezulton me jo baraspeshë edhe më të madhe. Si pasojë e sistemit të këtillë të pa unifikuar, ka pakënaqësi dhe demotivim te pjesa më e madhe e të punësuarve, si dhe paraqitet largimi i kuadrove nga institucionet publike.³

³ STRATEGJIA PËR REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2018 – 2022, 1.12.2017 http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.pdf

I. PAGAT E NËPUNËSVE ADMINISTRATIV

I. 1. LËVIZJA E PAGAVE TË NËPUNËSVE ADMINISTRATIV SHTETËROR

Në bazë të ligjit për nëpunës administrativ, nëpunës administrativ është person i cili ka themeluar marrëdhënie pune për shkak të kryerjes së punëve administrative në **organet e pushtetit shtetëror dhe lokal dhe institucionet që kryejnë veprimtari nga fusha e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijës, sportit, si dhe në veprimtari të tjera me interes publik, të cilat janë të organizuara si agjenci, fonde, institucione publike dhe ndërmarrje publike, të themeluara nga Republika e Maqedonisë ose nga komunat dhe nga qyteti Shkup**. Nëpunësi administrativ mund të jetë **nëpunës shtetëror**, nëse është i punësuar në organet e pushtetit shtetëror dhe lokal, **dhe nëpunës publik**, nëse është i punësuar në institucionet që kryejnë veprimtari në fushën e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijës, sport, si dhe në veprimtari të tjera me interes publik.

Çështje të caktuara në lidhje me marrëdhënien e punës të nëpunësve administrativ në gjyqësor dhe prokurori publike, diplomati, doganë dhe administratën doganore, shërbimet inspektuese, revizioni shtetëror dhe revizioni i IPA, trupat rregullator dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, tërësisht ose pjesërisht janë të rregulluara me ligje të veçanta dhe marrëveshje kolektive që janë të ndryshme nga Ligji për nëpunësit administrativ⁴.

Paga e nëpunësve administrativ përbëhet **nga komponenti themelor dhe komponenti i jashtëzakonshëm**. Komponentin themelor të rrogës e përbëjnë:

- pjesa e pagës për shkallën e arsimit,
- pjesa e pagës për nivel dhe
- pjesa e pagës për stazh.

Pjesa e pagës për shkallën e arsimit dhe niveli në të cilin është vendosur nëpunësi administrativ vlerësohet me pikë përkatëse, ndërsa vlera e pikëve për përllogaritjen e pagave të **nëpunësve shtetëror** përcaktohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose në komunat dhe në Qytetin Shkup me vendim të Këshillit të komunës, Qyteti Shkup, për çdo vit në veçanti⁵. Vlera e pikëve për përllogaritjen e pagave të **nëpunësve publik** përcaktohet me vendim të themeluesit, me propozim të funksionarit kompetent, dhe mund të jetë më e lartë nga pikët e nëpunësve shtetëror. Pjesa e pagës për stazhin e punës të nëpunësit administrativ vlerësohet në shume prej 0.5% të pjesëve të pagës për shkallën e arsimit dhe për nivelin.

Komponentin e jashtëzakonshëm e përbëjnë:

- shtesa e pagës për kushte të posaçme për punë (punë e ekspozuar në rrezik të lartë ose punë në kabinet),
- shtesë e pagës për shkak të përshtatjes në tregun e punës dhe / ose
- shtesë e pagës për punë natën, punë në turne dhe punë jashtë orarit të punës⁶.

Komponenti themelor i pagës së nëpunësve administrativ shtetëror (pjesa e pagës për shkallën e arsimit dhe pjesa për pagë për nivel) lëviz prej 18.893 denarë bruto pagë mujore për ndihmës nëpunës administrator shtetëror profesional i nivelit të katërt, deri në 80.256 denarë bruto pagë mujore për sekretar të nivelit të parë.

⁴ LIGJI PËR NËPUNËSIT ADMINISTRATIV, neni 4; http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.pdf


⁵ VENDIM PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË PIKËVE PËR PËRLLOGARITJEN E PAGAVE TË NËPUNËSVE ADMINISTRATIV PËR VITIN 2017 <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/bbbbe866c8e5449a83fcdc5541d6d858.pdf> f.26

⁶ LIGJI PËR NËPUNËSIT ADMINISTRATIV, neni 87; http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.pdf

Tabela 1. Komponenti themelor i bruto pagës të nëpunësit administrativ shtetëror për vitin 2017 (në muaj)


Nëpunës administrativ shtetëror	Pikë (arsim + nivel)	Bruto pagë	Neto pagë
A1 – sekretar nivelit të parë (sekretar shtetëror)	1.045	80.256,0	53.464,0
A2 – sekretar i nivelit të dytë (sekretar gjeneral)	906	69.580,8	46.450,0
A3 - sekretar i nivelit të tretë (sekretar i qytetit Shkup)	861	66.124,8	44.179,0
A4 – sekretar i nivelit të katërt (sekretar i komunave në qytet)	796	61.132,8	40.899,0
A5 – sekretar i nivelit të pestë (sekretar i komunave në fshat)	706	54.220,8	36.358,0
B1 – nëpunës administrativ udhëheqës i nivelit të parë	716	54.988,8	36.863,0
B2 – nëpunës administrativ udhëheqës i nivelit të dytë	696	53.452,8	35.854,0
B3 – nëpunës administrativ udhëheqës i nivelit të tretë	606	46.540,8	31.312,0
B4 – nëpunës administrativ udhëheqës i nivelit të katërt	546	41.932,8	28.285,0
V1 – nëpunës administrativ profesional i nivelit të parë	481	36.940,8	25.005,0
V2 – nëpunës administrativ profesional i nivelit të dytë	421	32.332,8	21.978,0
V3 – nëpunës administrativ profesional i nivelit të tretë	406	31.180,8	21.221,0
V4 – nëpunës administrativ profesional i nivelit të katërt	376	28.876,8	19.707,0
G1 – nëpunës administrativ ndihmës - profesional i nivelit të parë	296	22.732,8	15.671,0
G2 – nëpunës administrativ ndihmës - profesional i nivelit të dytë	281	21.580,8	14.914,0
G3 – nëpunës administrativ ndihmës - profesional i nivelit të tretë	266	20.428,8	14.157,0
G4 – nëpunës administrativ ndihmës - profesional i nivelit të katërt	246	18.892,8	13.148,0

Grafiku 1. Komponenti themelor i bruto pagës të nëpunësve administrativ shtetëror për vitin 2017



Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 1 dhe grafikun 1 dhe 2, mund të vërehet se **sekretarët shtetëror (sekretar i nivelit të parë) kanë bruto të ardhura mujore më të larta (pa përfshirë shtesën për stazh) prej 80.256 denarë, respektivisht 53.464 denarë neto të ardhura**, ndërsa, nga ana tjetër, **të ardhura më të ulëta kanë punëtorët ndihmës profesional të nivelit të katërt**, për të cilët kërkohet arsim i mesëm dhe të cilët kanë minimum bruto të ardhura mujore (pa përfshirë shtesën për stazh) **prej 18.892 denarë, respektivisht 13.148 denarë neto.**

Grafiku 2. Komponenti themelor i neto pagës së nëpunësve administrativ shtetëror për vitin 2017



I. 2. NETO DHE BRUTO PAGAT MESATARE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË RAPORT ME NETO DHE BRUTO PAGAT MESATARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NGA VITI 2010 DERI MË SOT

Sipas Entit Shtetëror për Statistikë, “Bruto pagat e përgjithshme të paguara përfshijnë: neto paga të paguara për muajin raportues, tatim personal i paguar dhe kontribute të paguara për: sigurim pensional dhe invalidor, për sigurim shëndetësor, për punësim, për sëmundje profesionale. Neto pagat e përgjithshme të paguara përfshijnë: neto paga e paguar për muajin raportues për punë me orar të plotë, më të shkurtër se orari i plotë dhe më i gjatë se orari i punës i plotë (punë jashtë orarit), kompensimet për neto pagën nga fondet e subjektit afarist për pushim vjetor, festa shtetërore, pushim të paguar deri në shtatë ditë , pushim të paguar për arsim profesional, pushim mjekësor deri në 21 ditë, etj., pagesa për neto pagën të paguar

nga punëdhënësit e tjerë për kohën e kaluar në ushtrim me ftesë të organit shtetëror kompetent, mbrojtje civile etj.⁷.

Tabela 2. Bruto paga mujore dhe neto paga në sektorin Administratë publike⁸, sigurim i detyrueshëm social në Republikën e Maqedonisë, krahasuar me bruto pagën mujore dhe neto pagën në RM gjatë periudhës nga viti 2010 deri më sot dhe numri i të punësuarve⁹

	Bruto paga ¹⁰			Neto paga			Numri i të punësuarve në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sig. social ¹¹	% nga gjithsej të punësuar në RM
	Mesatare në denarë	Paga mesatare në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social	Paga mesatare / paga mesatare në administratën publike	Mesatare në denarë	Paga mesatare në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social	Paga mesatare / paga mesatare në administratën publike		
2010	30.225	36.800	122%	20.553	24.855	121%	42.474	15,02
2011	30.602	36.715	120%	20.847	24.826	119%	43.258	14,91
2012	30.669	36.901	120%	20.902	24.967	119%	44.006	14,78
2013	31.025	37.057	119%	21.145	25.055	118%	44.102	15,39
2014	31.325	37.460	120%	21.394	25.326	118%	44.262	15,59
2015	32.173	38.387	119%	21.906	25.940	118%	46.774	15,09
2016	32.822	39.633	121%	22.342	26.734	120%	47.364	15,28
2017 muaji XI	34.079	41.294	121%	23.196	27.805	120%		

⁷ Internet faqja zyrtare e Entit Shtetëror për Statistikë e Republikës së Maqedonisë, 2.10.2015 http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.prf

⁸ SHËNIM: [ISIC Rev.4 code O, UNSTATS], Administrata publike, mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm social kategorija i përfshin veprimtaritë e natyrës administrative, të cilat sipas rregullit i kryen administrata publike. Këtu përfshihen ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe implementimi i ligjeve dhe akteve nënligjore, dhe implementimi i aktiviteteve që rezultojnë si obligim ligjor, punët profesionale në lidhje me përpilimin e rregullave, tatimitin, mbrojtjen nacionale, rendin publik dhe paqen, shërbimet e emigrantëve, punë të jashtme dhe implementimi i politikave qeveritare. Në kategorinë janë përfshirë edhe veprimtari nga fusha e sigurimit të detyrueshëm social.

⁹ Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës


http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.prf

¹⁰ Në pajtim me metodologjinë e Bankës Popullore të Maqedonisë të dhënat për neto dhe bruto pagat e paguara për të punësuar bazohen mbi raportet mujore të subjekteve afariste dhe tjetra pronë (shoqërore, shtetërore, bashkuese dhe e përzier) me veprimtari të ndryshme në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me të dhënat e përpiluara nga Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë.

¹¹ Në këtë klasifikim të veprimtarive bëjnë pjesë të gjithë të punësuarit që e përbëjnë seksionin 84 të Klasifikimit Kombëtar të veprimtarive – KKV Rev. 2 dhe sipas regjistrimit në Regjistrin qendror. Këtu bëjnë pjesë të gjitha nënkategoritë e veprimtarisë: Administrata shtetërore, politika ekonomike dhe sociale e vendit (veprimtaritë e përgjithshme të administratës publike, rregullimi i veprimtarive të institucioneve që ofrojnë kujdes shëndetësor, arsimit dhe kulturë dhe shërbime të tjera sociale, menaxhim dhe dhënie ndihmës për biznes më të suksesshëm), Ofrimi i shërbimeve për vendin si tërësi (çështjet e jashtme, çështjet e mbrojtjes, aktivitetet gjyqësore dhe të jurisprudencës, rendi publik dhe çështjet e sigurisë, veprimtaria e zjarrfikësve), veprimtari të sigurimit të detyrueshëm social

http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.prf


Grafiku 3. Bruto pagat mujore dhe neto pagat në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social në Republikën e Maqedonisë, krahasuar me bruto pagën mujore dhe neto pagën në RM gjatë periudhës nga viti 2010 deri më sot dhe numri i të punësuarve



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Nga të dhënat e paraqitura në Tabela 2 dhe grafiku 3, nga viti 2010 deri më sot mund të vërehet trend i rritjes së bruto pagës mujore mesatare në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social edhe atë prej 36.800 në vitin 2010 në 41.300 në fund të vitit 2017 (nëntor). Trendi i këtillë i rritjes është më i lartë se rritja e bruto pagës mesatare mujore, e cila nga 30.255 denarë në vitin 2010 u rit në 34.079 denarë, që do të thotë se dallimi ndërmjet bruto pagës mujore mesatare në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social dhe bruto paga mujore mesatare në RM nga **6.575 denarë** në vitin 2010 u rrit në **7.215 denarë** në nëntor 2017. Trend të njëjtë shënon edhe neto shuma, e cila nga 24.855 denarë në vitin 2010 u rrit në 27.805 denarë në nëntor 2017, që në raport me neto pagën mesatare mujore është për **4.300 denarë** më tepër krahasuar me vitin 2010, gjegjësisht për **4.609 denarë** në nëntor 2017. Gjithashtu, është me rëndësi të përmendet se numri i të punësuarve në Sektorin administratë publike dhe mbrojtje, dhe sigurim i detyrueshëm social është në rritje të vazhdueshme dhe nga **42.474 në vitin 2010 është rritur në 47.364 në vitin 2016, që paraqet rreth 15% nga të punësuarit e përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës së analizuar (grafiku 2).**

Grafiku 4.Bruto paga mesatare mujore në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, krahasuar me sektorët tjerë në veprimtarisë në nëntor 2017¹²



¹² Neto paga mesatare e paguar për të punësuar, në veprimtaritë e sektorit, sipas KKV Rev. 2, në nivel mujor

Nga të dhënat e ilustruara në grafikun 4 mund të vërehet se në nëntor 2017 bruto paga mesatare mujore dhe neto paga në Sektorin administratë publike dhe mbrojtje, dhe sigurim i detyrueshëm social është më e lartë nga më shumë sektorë të veprimtarisë, respektivisht vetëm sektorët: Veprimtari financiare dhe **veprimtari të sigurimit me 62.789 denarë bruto dhe 42.204 denarë neto pagë**, Informata dhe komunikacione me 54.716 denarë bruto dhe 36.919 denarë neto pagë, Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim me 54.355 denarë bruto dhe 36.446 denarë neto pagë, pastaj Miniera dhe nxjerrja e gurit me 42.912 denarë bruto dhe 28.979 denarë neto pagë, dhe Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike me 41.827 denarë bruto dhe 28.507 denarë neto pagë, kanë bruto paga mesatare mujore dhe neto paga më të larta se bruto dhe neto pagat mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë, ndërsa nga ana tjetër, të gjithë sektorët e veprimtarisë kanë bruto dhe neto të ardhura më të vogla. Të ardhura mujore më të ulëta kanë të punësuarit në sektorët Shërbime administrative dhe veprimtari ndihmëse shërbyese, ku paga mujore mesatare është 24.762 denarë bruto dhe 17,077 denarë neto, dhe sektori Objektet për akomodim dhe shërbime me ushqim, ku paga mesatare mujore është më e ulët dhe është 24.205 denarë bruto dhe 16.656 denarë neto.

¹³ Të dhënat janë përlogaritje e autorit dhe janë fituar si sasi e zërit bruto paga për secilin përdorues buxhetor në veçanti me numër të të punësuarve në vitin përkatës.


I.3. BRUTO DHE NETO PAGA PËR NJË PJESË TË SHFRYTËZUESVE BUXHETOR TË BUXHETIT QENDROR NGA VITI 2016 DERI NË VITIN 2018¹³

Tabela 3. Shpenzime për bruto dhe neto paga për të punësuarit (mujore) në një pjesë të shfrytëzuesve buxhetor – Buxheti qendror¹⁴

Shpenzime për shfrytëzues buxhetor - Buxheti Qendror	Buxheti 2016 bruto	Buxheti 2016 neto	Bruto për-fundues 2016	Neto për-fundues 2016	Buxheti 2017 bruto	Buxheti 2017 neto	Buxheti 2018 bruto	Buxheti 2018 neto
Sekretariati për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë	29,350	20,019	26,542	18,174	28,256	19,310	28,445	19,441
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	28,586	19,517	28,243	19,292	28,876	19,717	30,830	21,008
Ministria për shoqëri informatike dhe administratë	28,722	19,606	28,601	19,527	31,070	21,159	37,419	25,337
Qeveria e Republikës së Maqedonisë	37,793	25,566	29,347	20,017	48,147	32,378	47,724	32,108
Ministria e Financave	32,521	22,102	30,543	20,802	33,599	22,820	34,438	23,379
Ministria e Drejtësisë	33,107	22,487	31,987	21,751	32,293	21,962	33,828	22,978
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	32,663	22,195	32,339	21,982	32,141	21,862	32,206	21,913
Bruto Paga mesatare në RM	32,822	22,300	32,822	22,340	32,867	22,339		
Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor	37,903	25,638	35,241	23,889	37,467	25,362	35,613	24,151
Ministria e Ekonomisë	39,489	26,680	35,903	24,324	39,155	26,470	41,040	27,716
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	34,580	23,455	35,932	24,343	37,125	25,137	36,711	24,872
President i Republikës së Maqedonisë	52,178	35,017	42,520	28,671	51,341	34,476	47,499	31,960
Ministria e Shëndetësisë	42,281	28,514	42,530	42,530	45,893	30,897	40,884	27,614
Shpenzimet mesatare për pagat dhe kompensimet për shfrytëzuesit e buxhetit	42,563	28,700	42,563	28,700				
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	46,502	31,287	45,278	30,484	47,192	31,751	46,193	31,102
Komisioni Shtetëror Zgjedhor	40,152	27,116	56,377	33,381	43,364	29,236	41,453	27,988
Ministria e Punëve të Brendshme	47,334	31,834	57,153	34,331	51,527	34,599	52,711	35,384
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë	58,709	39,308	58,268	37,775	56,683	37,986	60,373	40,418
Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë	53,001	35,557	64,257	57,153	57,942	38,813	55,262	37,060
Agjencia për Kundërzbulim	50,565	33,957	58,268	39,018	60,766	40,669	55,774	37,397
Enti Shtetëror për Revizion	65,916	44,042	64,257	42,953	65,641	43,872	67,854	45,333
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë	65,742	43,928	66,019	44,110	66,516	44,446	66,750	44,608
Ministria e Punëve të Jashtme	91,584	60,906	80,033	53,317	87,112	57,978	92,495	61,522
Agjencia për Investime të Huaja dhe Promovimin e Eksportit	100,308	66,638	96,071	63,854	96,088	63,875	41,897	28,279

¹⁴ Raport vjetor i REGJISTRIT TË TË PUNËSUARVE NË SEKTORIN PUBLIK 2016 http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.pdf


Grafiku 5. Shpenzime për bruto paga për të punësuarit në një pjesë të shfrytëzuesve buxhetor¹⁵ të Buxhetit qendror për vitin 2016¹⁶



¹⁵ Shfrytëzuesit e zgjedhur janë sipas numrit të personave të punësuar dhe lartësia e mjeteve për paga dhe kompensime.

¹⁶ Të dhënat për numrin e të punësuarve janë në bazë të buxheteve për 2016, 2017 dhe 2018, ndërsa për shpenzimet për paga dhe kompensime, sipas llogarisë përfundimtare për 2016 dhe buxhetet për 2017 dhe 2018. Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat e zgjedhur dhe të emëruar (ministrat, zëvendësit, drejtorët dhe zyrtarët e tjerë) që punojnë në institucionet përkatëse dhe shpenzimet që institucionet kanë për pagat dhe kompensimet për këta persona

Grafiku 6. Shpenzime mujore të realizuara për neto paga për të punësuarit në një pjesë të shfrytëzuesve buxhetor¹⁷ të Buxhetit qendror për vitin 2016¹⁸



¹⁷ Shfrytëzuesit e zgjedhur janë sipas numrit të personave të punësuar dhe lartësia e mjeteve për paga dhe kompensime.


¹⁸ Të dhënat për numrin e të punësuarve janë në bazë të buxheteve për 2016, 2017 dhe 2018, ndërsa për shpenzimet për paga dhe kompensime, sipas llogarisë përfundimtare për 2016 dhe buxhetet për 2017 dhe 2018. Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat e zgjedhur dhe të emëruar (ministrat, zëvendësit, drejtorët dhe zyrtarët e tjerë) që punojnë në institucionet përkatëse dhe shpenzimet që institucionet kanë për pagat dhe kompensimet për këta persona

Sipas të dhënave në buxhetin për vitin 2016, numri i të punësuarve në shfrytëzues buxhetor është **50.723**, ndërsa shuma e shpenzimeve totale për paga dhe kompensime për vitin 2016 është 25.907.403.000, që do të thotë se shuma mesatare për paga dhe kompensime (bruto shuma) për të punësuar nga të gjithë përdoruesit buxhetor të Buxhetit qendror është **42.563 denarë, që është pothuajse për 10,000 denarë shumë më e lartë në krahasim me pagën mesatare bruto në Republikën e Maqedonisë për vitin 2016¹⁹ ose neto pagën mesatar mujore e paguar për të gjithë shfrytëzuesit buxhetor për vitin 2016 është 28,700 denarë, që nga ana tjetër, është më e lartë për 6,360 denarë sesa paga neto mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë.²⁰ Nga shfrytëzuesit buxhetor të analizuar, mund të konkludohet se mjete më të mëdha për paga bruto dhe neto për punonjës në nivel mujor në vitin 2016 janë rezervuar për **Agjencinë për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit, nga 96.071 denarë bruto pagë mesatare për punonjës, d.m.th. 63,854 denarë neto pagë mesatare për punëtor, pas saj vijon Ministria e Punëve të Jashtme me 80,033 denarë bruto pagë mujore e paguar për një të punësuar ose 53,317 denarë neto pagë mesatare mujore e paguar për punëtor, pastaj vijojnë të punësuarit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, ku bruto paga mesatare mujore për punëtor është 66,019 denarë ose 44,110 denarë neto pagë mesatare mujore për punonjës dhe Enti Shtetëror i Statistikës me bruto pagë mesatare mujore për të punësuar prej 64,257 denarë ose 42,953 denarë neto pagë mesatare mujore për punonjës. Nga ana tjetër, shpenzimet më të ulëta mujore për bruto dhe neto pagë në vitin 2016 janë realizuar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, ku mesatarisht për të punësuar janë realizuar 29.347 denarë bruto, ose 20.017 denarë neto pagë, pastaj vijon Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës me 28.601 denarë, respektivisht me 19.527 denarë neto – pagë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me 28.243 denarë bruto, respektivisht me 19.292 denarë neto pagë mesatare mujore për të punësuar dhe **Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit me bruto pagë mujore më të ulët për të punësuar prej 26.542 denarë ose 18.174 denarë neto pagë mujore për të punësuar.******

¹⁹ Buxheti i RM-së 2018, f. 21 deri në 68; http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.pdf

²⁰ Të dhënat për neto pagat janë përlogaritje e vetë autorit <http://plata.m.ie.mk/>

Grafiku 7. Ndryshim tek shpenzimet e projektuara për paga dhe kompensime për të punësuar për vitin 2017/2016, 2018/2017 dhe 2018/2016 për një pjesë të shfrytëzuesve buxhetor²¹ të Buxhetit qendror²²



²¹ Shfrytëzuesit e zgjedhur janë sipas numrit të personave të punësuar dhe lartësia e shpenzimeve për paga dhe kompensime.

²² Të dhënat për numrin e të punësuarve janë në bazë të buxheteve për 2016, 2017 dhe 2018, ndërsa për shpenzimet për paga dhe kompensime, sipas llogarisë përfundimtare për 2016 dhe buxhetet për 2017 dhe 2018.

Sa u përket shpenzimeve të planifikuara për bruto pagat për një pjesë të shfrytëzuesve buxhetor të Buxhetit qendror për vitin 2018, mund të vërehet se në lidhje me bruto pagat mujore të parashikuara në 2016, ndryshime të mëdha janë vërejtur te shpenzimet e projektuara për paga dhe kompensime në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, edhe atë, kemi rritje të pagave të projektuara mujore dhe kompensimeve për punëtor për 30% në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, si rezultat i rritjes së shumës për paga dhe kompensime prej 76,171,000 në vitin 2016 në 94,744,000 në vitin 2018, dhe reduktimin e numrit të të punësuarve nga 221 në 211. Një tjetër reterim të rëndësishëm në kuptimin pozitiv kemi në Qeverinë e RM-së, edhe atë rritje për 26% të pagës mesatare bruto për punonjës, gjë që ndodh kryesisht për shkak të reduktimit të numrit të të punësuarve nga 683 në 431, dhe alokimi i shumës së paraparë të të hollave për këtë qëllim ka rënë nga 309.755.000 denarë në vitin 2016 në 246.830.000 denarë në vitin 2018. Nga ana tjetër, Agjencia për Investimeve të Huaja dhe Promovimin e Eksportit ka pasur ulje të madhe të shpenzimeve të projektuara mujore për paga dhe kompensime për të punësuar për 58% në 2018 në raport me vitin 2016 që ka të bëjë me zvogëlimin e numrit të të punësuarve nga 82 në vitin 2016 në 58 në vitin 2018, respektivisht anulimin e promotorëve ekonomik.²³

I.4. SHPENZIME PËR PAGA DHE KOMPENSIME DHE PËR PUNËSIME TË PËRKOHSHME NGA SHPENZIMET E PËRGJITHSHME NË BUXHETIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR PERIUDHËN PREJ VITIT 2010 DERI NË VITIN 2018

Nga të dhënat në tabelën më lartë mund të vërehet se nga viti 2010 deri në vitin 2018, shpenzimet e dedikuara për paga dhe kompensime janë në linjë të rritjes edhe atë në vitin 2010 janë realizuar gjithsej 22.638.361.127 denarë, ndërsa nga ana tjetër, në vitin 2018 për këtë zë janë parashikuar 27.125.688.000 denarë. Nga aspekti i pjesëmarrjes së tyre në shpenzimet e përgjithshme, është e dukshme që ulja e zërit Paga dhe kompensime po zvogëlohet dhe pjesa e saj prej 15% në vitin 2010 është zvogëluar në 11.5% në 2018, dhe kjo është kryesisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore gjatë kësaj periudhe (nga 150.273.975.076 denarë për vitin 2010 në 234.408.721.000 denarë për vitin 2018). I njëjti trend i zvogëlimit është parë në pjesën e pagave dhe kompensimeve në BPV, kështu që pjesëmarrja e tyre prej 5.18% në vitin 2010 ka rënë në 4.22% në vitin 2017, kryesisht për shkak të rritjes së vlerës së PBV-së (grafiku 7). Nga ana tjetër, shpenzimet për punësim të përkohshëm kanë disa luhajtje gjatë viteve, d.m.th. vlera e tyre është më e larta në vitin 2010, duke arritur në 858,365,159 denarë ose 0.58% të shpenzimeve totale të buxhetit, që vitin e ardhshëm vlera e shpenzimeve të realizuara për zërin punësim të përkohshme të pësojë rënie në mënyrë drastike për 97,842,273 denarë ose 0.06% të shpenzimeve të përgjithshme. Kjo për shkak të transformimit të një pjese të madhe të të punësuarve (rreth 5.000) nga persona me punësim të përkohshëm në persona me punësim të përhershëm²⁴. Ky numër i punësimeve të përkohshme në periudhën e ardhshme tregon një prirje të lehtë rënëse nga viti 2017, kur janë parashikuar 51.176,00 denarë, përkatësisht 0.02% të shpenzimeve totale dhe në vitin 2018 është regjistruar një rritje e lehtë e shpenzimeve të parashikuara për punësim të përkohshme në vlerë prej 78.928.000 denarë ose 0.03% të shpenzimeve totale.

²³ <http://24vesti.mk/namesto-promotori-ekonomski-atashea-kje-privlekuvaat-stranski-investicii>


²⁴ <https://www.mkd.mk/makedonija/ekonomija/chetvorica-vrboten-i-vo-privatniot-sektor-izdrzhuvaat-po-eden-administrativec>

Tabela 4: Shpenzime për paga dhe kompensime dhe për punësime të përkohshme nga shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit të RM-së për periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2018


Shpenzime	përfundimtare 2010	përfundimtare 2011	përfundimtare 2012	përfundimtare 2013	përfundimtare 2014	përfundimtare 2015	përfundimtare 2016	2017	2018
GJITHSEJ	150,273,975,076	156,851,453,025	161,243,269,689	174,818,509,114	183,305,854,706	187,140,216,413	206,193,096,931	224,746,501,000	234,408,721,000
PAGA DHE KOMPENSIME	22,638,361,127	23,146,054,570	22,713,364,350	22,562,801,207	23,095,250,464	23,412,890,000	25,956,828,071	26,771,550,000	27,125,688,000
Paga themelore	16,173,507,597	16,596,142,945	16,267,568,189	16,128,825,532	16,498,999,659	16,723,028,000	18,561,601,708	19,096,559,000	19,403,233,000
Kompensime për sigurim social	6,394,062,371	6,495,750,898	6,391,860,482	6,370,388,920	6,528,317,635	6,614,911,000	7,345,473,161	7,627,822,000	7,676,364,000
Kontribute të tjera nga paga	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kompensime	70,791,159	54,160,727	53,935,679	63,586,755	67,933,170	74,951,000	49,753,202	47,169,000	46,091,000
MALLRA DHE SHËRBIME	31,700,671,829	32,037,359,069	33,464,952,341	34,010,706,586	35,232,490,415	38,993,903,710	38,720,868,552	42,946,749,000	42,560,062,000
Punësime të përkohshme	858,365,159	97,842,273	72,774,398	80,710,548	64,663,428	86,695,000	59,965,231	51,176,000	78,928,000
BPV	437,296,000,000	464,187,000,000	466,703,000,000	501,891,000,000	527,631,000,000	558,240,000,000	607,452,000,000	634,435,000,000	
PAGA DHE KOMPENSIME % nga gjithsej	15.06%	14.76%	14.09%	12.91%	12.60%	12.51%	12.59%	11.91%	11.57%
Punësime të përkohshme % nga gjithsej	0.57%	0.06%	0.05%	0.05%	0.04%	0.05%	0.03%	0.02%	0.03%
Paga dhe kompensime % të BPV	5.18%	4.99%	4.87%	4.50%	4.38%	4.19%	4.27%	4.22%	

Burimi: Buxheti dhe llogaria përfundimtare e buxhetit të RM-së për periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2018

Grafiku 8: Shpenzime për paga dhe kompensime nga shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit të RM-së për periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2018



Grafiku 9: Shpenzime për paga dhe kompensime si % nga shpenzimet e përgjithshme të Buxhetit të RM-së për periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2018 dhe % e BPV-së



I.5. BRUTO DHE NETO PAGAT NË TRUPAT RREGULLATOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2016

“Trupat rregullator janë organizata të themeluara nga Qeveria me përgjegjësi që t’i monitorojnë, udhëzojnë dhe kontrollojnë sektorët e ndryshëm industrialë në interes të mbrojtjes së konsumatorit.” Prandaj, mënyra primare me të cilën formohen trupat rregullator në Republikën e Maqedonisë paraqet ligji material me të cilin rregullohen mekanizmat për funksionimin e një sektori të caktuar ekonomik, për të cilin nevojitet të ekzistojë edhe trup përkatës me autorizime publike të akorduara për rregullim të pavarur dhe autonom, respektivisht kontrollimin e punëve në atë sektor. Rrjedhimisht, edhe e drejta e pagës në trupat rregullator në Republikën e Maqedonisë është e përcaktuar me ligje të veçanta me të cilat ato janë formuar²⁵. Në tabelën më poshtë janë prezantuar bruto dhe neto pagat mesatare për të punësuarit në trupat rregullator në Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, në pajtim me raportet vjetore dhe financiare të çdo institucioni dhe sipas të dhënave të qasshme në raportin vjetor nga regjistri i të punësuarve në sektorin publik për vitin 2016.

Tabela 5. Shpenzime për bruto dhe neto pagat për të punësuar (mujore) në trupat rregullator të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016


Shpenzime për bruto dhe neto paga në trupat rregullator	Bruto paga mesatare për të punësuar	Numri i të punësuarve ²⁶	Shpenzime për bruto – paga për vitin 2016	Neto paga mesatare për të punësuar
Komisioni Rregullator për Banim	136.194	4	6.537.329	90.215
Agjencia për Rregullimin e Sektorit Hekurudhor	107.316	2	2.575.588	71.242
Komisioni Rregullator për Energjetikë	100.185	26	31.257.772	66.557
Agjencia për Aviacion Civil	98.657	69	82.871.896	65.553
Agjencia për Komunikime Elektronike (AKE)	88.301	128	135.631.308	58.749
Komisioni për Letra me Vlerë	88.002	23	22.264.451	58.553
Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve (AMS)	85.596	27	27.733.000	56.972
Agjensioni për mbikëqyrjen e finansimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)	65.921	29	22.940.657	44.046
Agjencia e Postave	64.009	17	13.057.806	42.790
Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale	58.291	50	34.974.838	39.033

Burimi: Raportet vjetore dhe financiare të trupave rregullator për vitin 2016


²⁵ Trupa rregullator – përfitim i suksesshëm? Valentin Fetaxhokoski, Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, 2017
http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/SRJA_2018-20022018_mk.pdf

²⁶ Të dhëna për numrin e të punësuarve në pajtim me Raportin vjetor të REGJISTRIT TË TË PUNËSUARVE NË SEKTORIN PUBLIK 2016

Grafiku 10. Bruto paga mujore për të punësuar në trupa rregullator në Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, krahasuar me bruto pagën mujore mesatare në RM dhe bruto pagën mesatare mujore në sektorin Administratë Publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social



Grafiku 11. Neto paga mujore për të punësuar në trupa rregullator në Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, krahasuar me neto pagën mesatare mujore në RM dhe neto pagën mesatare mujore në sektorin Administratë Publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social



Sa i përket shpenzimeve për paga në trupat rregullator, mund të vërehet se bruto paga mesatare dhe neto pagat të të gjitha 10 institucioneve janë më të larta se bruto dhe neto pagat mujore në shtet dhe lëvizin nga 58.291 denarë bruto pagë mujore për të punësuar, respektivisht 39.033 denarë neto pagë mesatare për të punësuar, në Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, deri në 136.194 denarë bruto pagë mujore mesatare për të punësuar ose 90.215 denarë neto pagë mujore mesatare për të punësuar në Komisionin rregullator për banim, që është për të paktën 25.469 denarë më tepër se bruto paga mujore mesatare ose për 16.733 denarë më tepër se neto paga mujore mesatare në RM, respektivisht për 18.658 denarë më tepër se bruto paga mujore mesatare në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social ose për 12.258 denarë më tepër nga neto paga mujore mesatare në sektorin administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social.

LISTA E BURIMEVE

1. Internet faqja zyrtare e Entit Shtetëror të Statistikës të Republikës së Maqedonisë
<http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=14>
2. Raport vjetor i REGJISTRIT TË TË PUNËSUARVE NË SEKTORIN PUBLIK 2016
http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/Godisen_izvestaj_2016_Registar_na_vraboteni_vo_JS.pdf
3. Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë <http://www.finance.gov.mk/>
4. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë; Raport tremujor i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë
<http://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-kvartalen-izvestaj-statisticki-prilog-2017.nspix>
5. SA DHE ÇFARË SEKTOR PUBLIK KEMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (RM)? Qendra për menaxhim me ndryshime (QMN) janar, 2017
[https://cup.org.mk/publications/Monitoring%20izvestaj_Mac_f%20\(2\).pdf](https://cup.org.mk/publications/Monitoring%20izvestaj_Mac_f%20(2).pdf)
6. Internet faqja zyrtare e Kuvendit të RM-së <http://www.sobranie.mk/>
7. Raporte vjetore dhe financiare të trupave rregullator për vitin 2016
8. <https://www.mkd.mk/makedonija/ekonomija/chetvorica-vraboteni-vo-privatniot-sektor-izdrzhuvaat-po-eden-administrativec>
9. STRATEGJIA PËR REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2018-2022 , 1.12.2017 .
http://mioa.gov.mk/files/pdf/dokumenti/Draft_SRJA_2018-2022_16122017_final_mk.pdf
10. LIGJI PËR NËPUNËSIT ADMINISTRATIV
http://www.mio.gov.mk/files/pdf/dokumenti/zakoni/zas/ZAS_konsolidiran_13022018.pdf
11. VENDIM PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË PIKËVE PËR PËRLLOGARITJEN E PAGAVE TË NËPUNËSVE SHTETËROR PËR VITIN 2017
<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/bbbbe866c8e5449a83fcdc5541d6d858.pdf> стр.26
12. Trupi rregullator – përfitim i suksesshëm? Valentin Fetaxhokoski, Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedonisë, 2017
<http://www.fosm.mk/CMS/Files/Documents/ANALIZA-2-MK.pdf>
13. Buxhet dhe llogaria përfundimtare e RM-së për periudhën 2010 deri në 2018

